

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Kushtet  
Aktvendim (Seancë e hapur)

1 E mërkurë, 28 qershor 2017

2 Hagë, Hollandë

3 Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Kushtetuese

4 [Aktvendim]

5 [Seancë e hapur]

6 --- Gjatë fillimit, në ora 12.00.

7 PORTIERI I GJYQIT: Të gjithë në këmbë.

8 Ju lutemi të uleni.

9 GJYKATËSJA POWER-FORDE: Lus sekretarin e lëndës të deklarojë lenden.

10 SEKRETARI I GJYKATËS: Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese  
11 të Dhomave të Specializuara të Kosovës, Gjykatëse *AnnPower-Forde*,  
12 kryesuese; Dr. Fidelma Donlon, administratore, dhe unë, RiazHaider,  
13 sekretar i çështjes; në çështjen numër KSC-CC-PR-2017-03, Referimi i  
14 Rregullave të rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe Provave, sipas  
15 Nenit 19(5) të Ligjit.

16 GJYKATËSJA POWER-FORDE: Mirëdita.

17 Hyrje.

18 Shpall hapjen e seancës së shqiptimit të Aktvendimit të Dhomës  
19 të Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në çëshjen e Referimit  
20 të Rregullave të rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe Provave  
21 sipas Nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara  
22 dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar të Kosovës.

23 Kryetarja e Dhomave të Specializuara, Gjykatësit e  
24 Plenares dhe publiku përgjithësisht, janë informuar në kohë për  
25 datën dhe kohën e mbajtjes së kësaj seance.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Kushtet  
Aktvendim (Seancë e hapur)

1 Seancën Plenare e cila nxorri këtë referim e kryesori Kryetarja  
2 e Dhomave të Specializuara të Kosovës, të cilës në emër të Panelit  
3 të Gjykatës Kushtetuese i uroj mirëseardhjen.

4 Procedura.

5 Rregullorja e Procedurës dhe e Provave e cila rregullon  
6 funksionimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës u miratua prej  
7 Gjykatësve të Dhomave të Specializuara, të mbledhur në Seancën  
8 Plenare, më 17 mars 2017.

9 Më 27 mars 2017, Rregullorja iu referua Dhomës së Specializuar  
10 të Gjykatës Kushtetuese, në përputhje me Nenin 19(5) të  
11 Ligjit për shqyrtimin e përputhshmërisë së saj me Kapitullin II,  
12 duke përfshirë Nenin 55 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës.

13 Në aktvendimin e 26 prillit 2017, Gjykata konstatoi se nga  
14 208 rregulla, nëntë prej tyre ishin në mospërputhje me Kapitullin II  
15 të Kushtetutës dhe për një Rregull nuk mund të deklaronte se ishte  
16 në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

17 Referimi.

18 Më 29 maj 2017, Plenarja, me përjashtim të gjykatësve kushtetues  
19 miratoi rregullat e rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe  
20 Provave.

21 Më 31 maj 2017, Rregullat e rishikuara iu referuan Gjykatës  
22 në përputhje me Nenin 19(5) të Ligjit.

23 Historiku.

24 Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese u  
25 formua në kuadër të Gjykatës Kushtetuese ekzistuese të Republikës

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Kushtet  
Aktvendim (Seancë e hapur)

1 së Kosovës dhe nëpërmjet shqyrtimit të kushtetutshmërisë së  
2 Rregullores së Procdurës dhe të Provave ushtron kompetencë mbikqyrëse  
3 mbi Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe  
4 rrjedhimisht, shërben si garantues shtesë i Kushtetutës.

5 Nga data e referimit, Gjykata kishte 30 ditë për shqyrtimin e  
6 Rregullave të rishikuara për të garantuar përputhshmërinë e tyre  
7 me Kapitullin II të Kushtetutës.

8 Më 8, 9, 23, dhe 24 qershor 2017, Dhoma e Specializuar e  
9 Gjykatës Kushtetuese zhvilloi kuvendime në privatësi, në lidhje me  
10 Rregullat e rishikuara.

11 Tani do t'paraqes një përmbledhje t'shkurtër të Aktvendimit që  
12 Gjykata miratoi sot, më 28 qershor 2017, dhe më pas, do t'lexoj  
13 dispozitat vendimore të tij.

14 Kjo përmbledhje nuk është pjesë e Aktvendimit dhe nuk është  
15 detyruese për Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese. Një  
16 kopje e kësaj përmbledhjeje do të vihet në dispozicion në fund të  
17 kësaj seance. Gjithashtu teksti i plotë i aktvendimit do të  
18 vihet në dispozicion n'faqen e internetit t'Dhomave të Specializuara.

19 Çështja.

20 Çështja që iu referua Dhomës së Specializuar të  
21 Gjykatës Kushtetuese ngren pytjen nëse Rregullat e rishikuara janë në  
22 përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.  
23 Kapitulli i dytë i Kushtetutës trajton të 'Drejtat dhe  
24 Liritë Themelore'.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Kushtet  
Aktvendim (Seancë e hapur)

1 Fillimisht, Gjykata konstatoi se referimi ishte i pranueshëm  
2 sepse ishte bërë në përputhje me Ligjin.

3 Për shqyrtimin e Rregullave të rishikuara, Gjykata u bazua në  
4 Nenin 19(2) të Ligjit i cili kërkon që Rregullorja t'pasqyrojë  
5 standardet më të larta të t'drejtës ndërkombëtare për të drejtat e  
6 njeriut, me synim garantimin e një gjykimi të drejtë dhe të shpejtë.

7 Vërejtje paraprake.

8 Gjykata vuri re se në përgjigje të Aktvendimit të Gjykatës të datës  
9 26 prill 2017, Plenarja ka ndryshuar një numër dispozitash në një mënyrë  
10 të tillë që kufizon, në disa raste në masë mjaft të konsiderueshme  
11 kompetencat e Prokurorit të Specializuar në lidhje me hetimin e veprave  
12 penale. Për shembull, Plenarja ka zvogëluar në masë të qenësishme kategorinë  
13 e personave në lidhje me të cilët mund të urdhërohen masa hetimore të  
14 posaçme dhe prej të cilëve mund të merren materiale të caktuara si prova.

15 Gjykata e vlerësoi të nevojshme të theksojë se Aktgjykimi i  
16 datës 26 prill 2017 nuk kishte për qëllim t'kufizonte n'terma të  
17 përgjithshme kapacitetin hetimor t'Prokurorit t'Specializuar. Një gjë  
18 e tillë mund t'pengonte Prokurorin e Specializuar në ushtrimin e  
19 detyrave ligjore të tij. Faktikisht, konstatimet e Gjykatës kishin  
20 për synim t'garantohej se në rastet kur ushtrimi i kompetencave  
21 hetimore të Prokurorit cenon të drejtat dhe liritë themelore të  
22 njeriut të garantuara me kushtetutë, është e detyrueshme që ky ushtrim  
23 kompetencash t'u nënshtrohet garancive mbrojtëse të duhura dhe aty ku është  
24 e domosdoshme, mbikqyrjes dhe kontrollit gjyqësor. Në këtë mënyrë arrihet  
25 drejtpeshimi i duhur midis interesave konkurrenente publike dhe private.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Kushtet  
Aktvendim (Seancë e hapur)

1 Konstatimet.

2 Rregulla 19, paragrafi 3 - Mungesa e një Gjykatësi.

3 Tani është e qartë se çdo gjykim para Dhomave të Specializuara  
4 t'Kosovës do t'jetë gjykim para një Gjykate t'themeluar me ligj, siç  
5 parashtrohet në Nenin 31.2 të Kushtetutës.

6 Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Rregulla 19(3) nuk është në  
7 mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

8 Rregulla 30 dhe Rregulla 31 - Dispozita e Përgjithshme dhe  
9 garanci minimale t'përgjithshme.

10 Gjykata vëren se në Rregullën 30, Plenarja ka përfshirë një  
11 kriter 'ombrellë' që përmban një numër 'dispozitash t'përgjithshme'  
12 të zbatueshme në lidhje me të gjitha hetimet dhe të cilët ndër të  
13 tjera, i ngarkojnë Prokurorit të Specializuar detyrimin për t'vepruar çdo  
14 herë në një mënyrë që është n'përputhje me të drejtat themelore t'njeriut.

15 Gjykata gjithashtu vëren se Plenarja ka miratuar një dispozitë të re,  
16 Rregullën 31, e cila mundëson disa 'Garanci Minimale të Përgjithshme' të  
17 zbatueshme n'lidhje me t'gjitha masat hetimore që mund t'cenojnë të drejtat  
18 themelore të njeriut. Masa të tilla mund të autorizohen dhe kryhen vetëm kur  
19 janë të 'domosdoshme për hetimin,' kur ndërhyrja e shkaktuar është  
20 'proporcionale me 'qëllimin legjitim të hetimit' dhe kur 'nuk mohon thelbin e  
21 të drejtës së garantuar'.

22 Gjykata i mirëpret këto dispozita plotësuese të hartuara me synimin e  
23 garantimit të një mbrojtjeje edhe më të madhe të t'drejtave themelore të  
24 njeriut dhe është e bindur se ato realizojnë kriteret e nevojshme kushtetuese.  
25 Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Rregulla 30 dhe Rregulla 31

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Kushtet  
Aktvendim (Seancë e hapur)

1 nuk janë në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

2 Rregulla 32 dhe Rregulla 33 - mbajtja, ruajtja, mbrojtja, kthimi  
3 dhe asgjësimi i materialit të mbledhur apo të sekuestruar.

4 Konstatimeve t'Gjykatës n'lidhje me pamjaftueshmërinë e garancive  
5 mbrojtëse në aspekte të ndryshme t'identifikuara në Aktvendimin e 26 prillit  
6 2017, Plenarja u është përgjigjur duke miratuar dispozita gjithpërfshirse.

7 Rregulla 32 dhe Rregulla 33 tani janë të zbatueshme n'lidhje me materialet e  
8 mbledhura nga Prokurori i Specializuar nëpërmjet masave hetimore të posaçme,  
9 kontrolimit dhe sekuestrimit si dhe n'lidhje me mbledhjen e mostrave trupore.

10 Sidoqoftë, Gjykata konstaton se megjithse ka parashtruar që  
11 materiale të tilla duhet të mbahen, ruhen dhe mbrohen në mënyrën e  
12 'duhur', Plenarja nuk ka përcaktuar procedurat që mundësojnë mbajtjen  
13 ruajtjen dhe mbrojtjen e duhur. Gjykata thekson se Plenarja ka  
14 zgjedhur që këto kompetenca t'ia delegojë një Paneli.

15 Gjykata pranon se nevojitet kohë dhe ekspertizë e konsiderushme  
16 për zhvillimin e procedurave t'hollësishme në lidhje me për shembull,  
17 si duhet të mbahen në 'mënyrën e duhur' të dhënat celulare,  
18 regjistrimet e bisedave private, apo materiale tjera të ndjeshme'.

19 Gjykata vlerëson se qasja e miratuar në Rregullat e rishikuara  
20 në praktikë mund të hasë në disa vështirësi dhe rrjedhimisht, do të  
21 jetë e nevojshme që të ketë udhëzime rregulluese konkrete për  
22 plotësimin e dispozitave ekzistuese, në veçanti, n'lidhje me aspektet  
23 teknike të tilla si ruajtja dhe mbajtja e llojeve të caktuara të të  
24 dhënave.

25 Gjithsesi, Gjykata konstaton se, duket se

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Kushtet  
Aktvendim (Seancë e hapur)

1 dispozitat e Rregullës 32 dhe Rregullës 33 nuk janë në mospërputhje  
2 me Kapitullin II të Kushtetutës.

3 Rregulla 34 - Kushtet për marrjen e masave hetimore  
4 të posaçme.

5 Rregulla 34 saktëson llojin e veprave penale në lidhje me të  
6 cilat mund të përliqjen masa hetimore të posaçme, ndër të cilat edhe  
7 urdhërat për përgjim. Gjithashtu, kjo rregull përkufizon kategorinë e  
8 personave, n'lidhje me t'cilët mund të urdhërohen masa hetimore të posaçme.

9 Duke mbajtur parasysh detyrimin procedural të Prokurorit të  
10 Specializuar për hetimin e efektshëm të veprave penale të caktuara,  
11 mund të ngrihet pyetja për sa i përket kategorisë së ngushtë të  
12 personave n'lidhje me t'cilët mund të urdhërohen masa hetimore të posaçme.

13 Gjithësesi, Gjykata konstaton se, duket se Rregulla 34 nuk  
14 është në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

15 Rregulla 35 dhe Rregulla 36 - Masa hetimore të posaçme të autorizuara  
16 prej një paneli ose të urdhëruara prej Prokurorit të Specializuar.

17 Rregulla 35 parashton masat hetimore të posaçme të autorizuara  
18 prej një Paneli. Kjo Rregull përcakton kufij të qartë në kohëzgjatjen  
19 e masave të tilla ndër të cilat mund të përfshihen vëzhgimi dhe përgjimi  
20 i fshehtë i komunikimeve dhe i ngarkon Panelit detyrimin për të përcaktuar  
21 periudhën kohore për të cilën jepet autorizimi. Poashtu, kjo rregull  
22 përcakton garanci mbrojtëse të efektshme, si për shembull një kufizim  
23 në periudhën fillestare gjatë të cilës mund të autorizohet një masë  
24 hetimore e posaçme, kushtet në bazë të cilave mund të zgjatet ajo periudhë,  
25 rrethanat në të cilat masat e autorizuara duhet

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Kushtet  
Aktvendim (Seancë e hapur)

1 të përfundojnë dhe kontrolli dhe mbikqyrja gjyqësore e domosdoshme  
2 në zbatimin e masës.

3 Rregulla 36 parashton masat hetimore të posaçme që mund të  
4 ndërmarrë Prokurori i Specializuar në rrethana t'përcaktuara dhe t'cilat  
5 i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor *ex post facto*.

6 Gjykata bindet se, duket se Rregulla 35 dhe Rregulla 36, nuk  
7 janë në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

8 Rregulla 37 dhe Rregulla 38 - Kontrollimi dhe Sekuestrimi i  
9 autorizuar prej një Paneli ose urdhëruar prej Prokurorit t'Specializuar.

10 Këto rregulla trajtojnë kontrollimet dhe sekuestrimet e autorizuara  
11 prej një Paneli ose të ndërmarra prej Prokurorit të Specializuar.

12 Gjykata gjykon se Rregulla 37 parashton një test më t'fortë të  
13 domosdoshmërisë n'lidhje me kushtet n'përputhje me t'cilat Prokurori i Speci-  
14 alizuar bën kërkesë për autorizim prej Panelit për kontrollim dhe sekuestrim.

15 Gjykata thekson se në interpretimin dhe vënien në zbatim të  
16 Rregullës 37, ndërsa garanton që çfarëdo ndërhyrje të jetë 'në  
17 përputhje me ligjin', Paneli gjithashtu duhet të ketë parasysh drejt-  
18 peshimin e duhur që duhet mbajtur midis të drejtave për integritet  
19 personal dhe privatësinë, nga njëra anë dhe domosdoshmërisë që  
20 Prokurori i Specializuar të kryejë një hetim të efektshëm, nga ana tjetër.

21 Rregulla 38 kërkon që Prokurori i Specializuar të marrë parasysh  
22 domosdoshmërinë e operacionit të kontrollimit dhe sekuestrimit dhe  
23 proporcionalitetin e ndërhyrjes përkatëse. Për më tepër, kjo rregull  
24 parashton shqyrtim gjyqësor *ex post facto* për sa u përket aspekteve në  
25 lidhje me ligjshmërinë dhe proporcionalitetin e masës.



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Kushtet  
Aktvendim (Seancë e hapur)

1 Gjykata është bindur se Plenarja i ka marrë parasysh konstatimet e  
2 Aktvendimit të 26 prillit 2017.

3 Gjykata konstaton se, duket se Rregulla 37 dhe Rregulla 38 nuk  
4 janë në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

5 Rregulla 39 - Kryerja e kontrollimit dhe sekuestrimit.

6 Rregulla 39 trajton, si kontrollimin me autorizim gjyqësor  
7 paraprak poashtu edhe kontrollimin dhe sekuestrimin me miratim gjyqësor  
8 *ex post facto*. Kjo rregull parashton shkallën e nevojshme të saktësisë  
9 në procedurat që duhen zbatuar në kryerjen e kontrollimit dhe sekuestrimit.

10 Në kontekstin e kryerjes së konrolimeve, Gjykata vëren se  
11 Rregullorja nuk përcakton konkretisht, konrolime të telekomanduara  
12 të pajisjeve të kompjuterizuara, synimi i të cilave është mbledhja e  
13 provave përkatëse ose kopijimi i të dhënave. Autoritetet hetimore  
14 i konsiderojnë gjithmonë e më shumë kontrollimet e telekomanduara  
15 të pajisjeve të të dyshuarve si një instrument hetimor i rëndësishëm  
16 dhe i domosdoshëm në luftën kundër veprave penale të rënda dhe komplekse.  
17 Duhet bërë dallim midis kontrollimeve të tilla të telekomanduara dhe  
18 kontrollimit të rëndomtë të diskut të palëvizshëm të kompjuterit të  
19 një të dyshuari dhe përgjimet e komunikimeve që kryhen përmes kompjuterit.

20 Ndërkohë që disa rregulla përmbajnë garanci mbrojtëse minimale në  
21 lidhje me aspektet e infiltrimit teknik, Gjykata i vlerëson kontrollimet e  
22 telekomanduara si një metodë me një shkallë të lartë ndërhyrëse që kërkon  
23 kushte më të rrepta për të garantuar që ndërhyrja përkatëse të mbetet brenda  
24 kufijve kushtetues të lejueshëm. Gjykata gjykon se Plenarja mund t'i marrë  
25 në shqyrtim çështjet e tilla në të ardhmen.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Kushtet  
Aktvendim (Seancë e hapur)

1 Gjithsesi, Gjykata konstaton se, duket se dispozitat ekzistuese të  
2 Rregullës 39 nuk janë në mospërputhje me Kapitullin II të  
3 Kushtetutës.

4 Rregulla 41 - Mbledhja e materialeve trupore për ekspertizë mjeko-ligjore.

5 Nëse vëren se Plenarja ka zvogëluar në masë të konsiderueshme,  
6 kategorinë e personave prej të cilëve mund të merren mostra trupore  
7 në bazë të një urdhëri të gjykatës, pa dhënien e pëlqimit, Gjykata  
8 gjithësesi konstaton se Rregulla 41 nuk është në mospërputhje me  
9 Kapitullin II të Kushtetutës.

10 Rregulla 57 (4) - Rishikimi dhe rivlerësimi i mbajtjes në paraburgim.

11 Gjykata arrin përfundimin se Rregulla 57(4), e cila përcakton  
12 lirimin e një personi brenda një shteti të tretë, nuk është në  
13 mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

14 Rregulla 137 - Dispozita të Përgjithshme.

15 Plenarja ka fshirë një dispozitë në lidhje me të cilën në  
16 Aktvendimin e vet të 26 prillit 2017, Gjykata nuk mundi të nxirrte  
17 konstatim në lidhje me përputhshmërinë e saj me Kushtetutën.

18 Gjykata konfirmon se Rregulla 137 nuk është në mospërputhje me  
19 Kapitullin II të Kushtetutës.

20 Rregulla 161 - Statusi i personit të shpallur të pafajshëm.

21 Rregulla 161 parashton se kur një person i paraburgosur shpallet i  
22 pafajshëm ai lirohet menjëherë, përveçëse kur mbahet në paraburgim  
23 në mënyrë të ligjshme ose vuan një dënim për vepra penale të tjera.

24 Gjykata konstaton se Rregulla 161 nuk është në mospërputhje me  
25 Kapitullin II të Kushtetutës.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Kushtet  
Aktvendim (Seancë e hapur)

1 Dispozitat vendimore.

2 Për arsyet e lartpërmendura, Gjykata, njëzëri:

3 1. *Deklaron* se Referimi është i pranueshëm;

4 2. *Vlerëson* se Rregullat 19, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39,  
5 41, 57, 137 dhe Rregulla 161 nuk janë në mospërputhje me Kapitullin  
6 II të Kushtetutës;

7 3. *Vlerëson* se Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para  
8 Dhomave të Specializuara të Kosovës është në përputhje me Kapitullin  
9 II të Kushtetutës.

10 Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

11 Këtu përfundon seanca e pasdites, të cilën rrjedhimisht e  
12 deklaroj të mbyllur.

13 SEKRETARI I GJYKATËS: Të gjithë në këmbë.

14 --- Seanca dëgjimore ka përfunduar në orën 12.41.

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25